



E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës – Gjakovë**  
**01.nr. \_\_\_\_\_ /2019**  
**Dt.04.03.2019**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 3 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.03.2019, pas diskutimit lidhur me pikën e 3-të, të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011-78935/2015 i datës 27.10.2015 për Shpallje të Interesit Publik të Monumentit Kulturor dhe Historik “Kulla Sylejman Vokshi, e miratoi këtë:

## V E N D I M

1. Ndryshohet pika 1 e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01.Nr 011/78935/2015 i datës 27.10.2015 për shpallje të Interesit Publik të Monumentit Kulturor dhe Historik Kulla e “ Sylejman Vokshi “. Zona Kadastrale Gjakovë – Qytet.
2. Parçelat me numër 1098/1, 1098/2, 1099/2 dhe 1099/3 Zona Kadastrale Gjakovë Qytet, që gjenden rreth monumentit Kulturorë nën mbrojtje të anulohen nga të gjitha procedurat e shpalljes së Interesit Publik dhe nga Procedurat e Shpronësimit dhe nuk janë pjesë e vendimit 01. Nr 011/78935/2015 i datës 27.10.2015. Këto prona kthehen në gjendjen e mëparshme të para datës 27.10.2015.
3. Pjesa tjetër e Vendimit 01. Nr 011/78935/2015 i datës 27.10.2015 mbetet në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. **Vendimi iu dërgohet:**
  - Kryetarit të Komunës, z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Drejtorisë për Kadastër Gjcodezi dhe Pronë
  - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kuvendi i Komunës

Shërbimi Profesional